



Shërbime të Seces

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KUVENDI
NR 4066 DATE 29.10.24

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2024

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin "Për statusin e minorit", shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike..

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETE

1. Jucela Tebelu
2. Gazment Bardhi
3. Agron Geshmarkaj
4. Ina Shyru
5. Ed. PALOKA
6. Xhela Alziri

[Handwritten signatures of several deputies]

[Handwritten signature]

8. KLESHNIK SOLAKI

9. Leftar Geshteagaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR STATUSIN E MINATORIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grup deputetësh të Partisë Demokratike,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin e minatorit në Shqipëri, duke siguruar mbrojtje të veçantë sociale dhe përmirësimin e kushteve të punës për këtë grup profesional, për shkak të natyrës së rrezikshme dhe specifike të punës që kryejnë.

Neni 2

Përkufizime

- Aksident në punë ose për shkak të punës** është një ngjarje e papritur gjatë procesit të punës që shkakton dëmtim trupor të individëve, si invaliditet të përkohshëm apo të përhershëm ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër në shëndet që ka të bëjë me punën dhe ushtrimin e punës;

2. **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**, një strukturë e ngritur pranë Ministrisë së Infrastrukturës, e cila ka për detyrë të vërtetojë plotësimin e kushteve për marrjen e statusit të minatorit
3. **Minator**, përfshin çdo individ i punësuar në sektorin e minierave, i angazhuar në nxjerrjen e mineraleve ose materialeve të tjera nëntokësore, si dhe çdo individ i cili ka ushtruar punën e mësipërme sipas legjislacionit në fuqi.
4. **Pension Suplementar**, kuptohet përfitimi financiar shtesë që i jepet minatorit pas daljes në pension për shkak të natyrës së punës së rëndë dhe të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi.
5. **Shërbime Shëndetësore**, kuptohet kujdesi mjekësor dhe mbrojtja shëndetësore që minatorët përfitojnë gjatë dhe pas përfundimit të karrierës së tyre.

Neni 3

Kushte Pune dhe Shëndeti

1. Minatorët kanë të drejtë për kushte pune të sigurta, që përfshijnë pajisje të duhura mbrojtëse, monitorim periodik të kushteve të mjedisit të punës dhe shërbime mjekësore të posaçme për të parandalur rreziqet shëndetësore.
2. Inspektoratet shtetërore do të kryejnë kontrole periodike të kushteve të punës në sektorin minierar për të siguruar që të gjitha rregullat e sigurisë të respektohen.
3. Minatorët duhet të kenë të drejtë për shërbime mjekësore të veçanta për sëmundjet profesionale që lidhen me sektorin e minierave.

Neni 4

E Drejta për Pension Suplementar

1. Minatorët përfitojnë pension të veçantë në përputhje me vitet e shërbimit dhe nivelin e rrezikshmërisë së profesionit.
2. Çdo minator që ka punuar të paktën 25 vite në minierë ka të drejtën të dalë në pension të parakohshëm, pa penaltete.
3. Pensioni suplementar për minatorët do të jetë 3% shtesë për çdo vit shërbimi mbi kufirin minimal të përcaktuar për pensionin bazë.

Neni 5

Trajnime dhe Zhvillim Profesional

1. Minatorët kanë të drejtë të marrin pjesë në programe të rregullta trajnimi për përmirësimin e aftësive të tyre profesionale dhe për të përmbushur kërkesat e sigurisë dhe teknologjisë bashkëkohore.
2. Shteti do të ofrojë mbështetje për përgatitjen e minatorëve për punësim alternativ pas daljes në pension apo në rast të paaftësisë për punë të mëtejshme në miniera.

Neni 6

Paga

Paga e minatorëve përcaktohet në kontratën kolektive, por në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se dyfishi i pagës minimale në vend.

Neni 7

Kompensime për Aksidente në Punë

1. Çdo minator që pëson aksident në vendin e punës ka të drejtë për kompensim të plotë për dëmtimin fizik apo mendor të shkaktuar nga aksidenti në punë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kujdesi shëndetësorë për çdo minator të dëmtuar për shkak të punës, do të jetë pa shpërblim në çdo institucion shëndetësor privat ose publik.

Neni 8

Sigurimi i Papunësisë

1. Minatorët që humbasin vendin e punës për shkak të mbylljes së minierave apo faktorëve të tjerë jashtë kontrollit të tyre, kanë prioritet për ripunësim në të njëjtim sektor apo sektor të tjerë.
2. Njësitë vendore ngarkohen nga ky ligj për të ripunësuar çdo minator në kushtet e pikës së parë.
3. Gjatë periudhës së papunësisë, minatorëve iu njihet e drejta të përfitojnë shpërblim në masën e pagës minimale duke shtuar dhe masën për vjetësi në punë për një periudhë 5 vjeçare.

Neni 9

Trajtimi i familjarëve në rast të humbjes së jetës në punë

1. Familja në ngarkim të përfituesit të këtij statusi, kur ky aksidentohet me vdekje gjatë kohës së punës, përfiton pension familjar në masën 50% të pagës së tij referuese, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Ky pension indeksohet njëjloj si pensionet e tjera.
2. Fëmijëve të përfituesve të këtij statusi, që janë aksidentuar më parë ose pas daljes së këtij ligji me vdekje në punë, kur ndjekin arsimin e lartë shteti u garanton bursë.

Neni 10

Përfitimi i pensioni

1. Çdo minator, i cili ka plotësuar vitet e punës sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit, ka të drejtë të përfitojë pension.
2. Pensioni do të llogaritet duke marrë pensionin bazë dhe atë suplementar të përcaktuar në pikën 3 të nenit 4.
3. Minatorët të cilët kanë punuar të paktën 10.5 vjet nëntokë mund të dalin në pension përpara 25 vjet punë por jo më pak se 20 vjet
4. Për ata që kanë përfituar pension të plotë ose invaliditeti, për ata që kanë dalë të papunë nga mbyllja e minierave përpara hyrjes në fuqi do të përfirojnë 50 përqind të kësaj mase.
5. Në asnjë rast pensioni nuk mund të jetë më i vogël se 130 përqind e pagës minimale.

Neni 11

Afati për përfitim

1. E drejta për të përfituar pensionin e pleqërisë, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.
2. Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë:
 - a) nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte;
 - b) një vit nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas më vonë se një vit nga afati i parashikuar në gërmën a.
3. Përfitimet e caktuara, por të pa tërhequra paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Neni 12

Financimi

1. Përfitimet nga ky ligj financohen nga kontributet shtesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, dhe nga Buxheti i Shtetit.
2. Personat, të cilët do të kryejnë procese në Industrinë Minerare nëntokë të përcaktuara në nenin 2, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të paguajnë kontribute shtesë në masën 1.5% të pagës bruto, për efekt kontributi., ndërsa 1.5% përqind do të paguhet nga punëdhënësi.
3. Kontributi shtesë i sigurimeve shoqërore, në masën 3%, mblidhet dhe derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme.

Neni 13

Trajtimi mjekësor dhe social

1. Përfituesit e statusit të minatorit dy herë në vit duhet të bëjnë kontrolle mjekësore falas në institucionet shtetërore apo private në vend.

2. Pranë çdo minierë do të ngrihen qendra mjekësore të pajisura me aparatura dhe mjekë specialistë që trajtojnë problematikën shëndetësore të shkaktuar nga puna nëntokë.
3. Ministria e shëndetësisë brenda 6 muajve nga shpallja e këtij ligji merr të gjitha masat e nevojshme për rivënien në funksion të pavionit të posaçëm për sëmundjet profesionale.
4. Ne rast sëmundjesh që vërtetohet se vijnë direkt ose indirekt nga puna në nëntokë, përfituesit e statusit të Minatorit përfitojnë kurim falas në institucionet publike apo private që janë në marrëdhënie me Fondin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.
5. Në rastet e sëmundjeve që vërtetohet se vijnë direkt ose indirekt nga puna nëntokë, që nuk kurohen brenda vendit, përfituesit e statusit duhet të kurohen falas jashtë vendit. Financimi i kurimit jashtë vendit bëhet nga :
 - a) buxheti i shtetit për ish-minatorët
 - b) 50 përqind nga buxheti i shtetit dhe 50 përqind nga punëdhënësi për minatorët
6. Barnat për kurimin e sëmundjeve të përfituesve të këtij statusi janë plotësisht të rimbursueshme.

Neni 14

Dokumentacioni për marrjen e statusit

1. Çdo individ që kërkon marrjen e statusit të minatorit duhet të bëjë kërkesë pranë komisionit të pavarur të minierave dhe mineraleve.
2. Për marrjen e statusit të minatorit, çdo individ duhet të paraqesi:
 - a) Librezë pune
 - b) Vërtetim për pagimin e sigurimeve shoqërore
3. Për marrjen e statusit të ish-minatorit duhet të paraqiten:
 - a) Librezë pune
 - b) Vërtetim pagë
 - c) Vërtetim për pagimin e sigurimeve shoqërore
4. Dokumentacioni dërgohet pranë Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve. Komisioni duhet të shqyrtojë brenda 15 ditëve plotësimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuar në këtë ligj.
5. Komisioni merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës për marrjen e statusit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Tiranës brenda 30 ditëve.

Neni 15

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

ELISA SPIROPALI

Miratuar, më ____ . ____ .2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë statusin e minatorëve në Shqipëri, duke garantuar mbrojtje të veçantë sociale dhe përmirësimin e kushteve të punës për këtë grup profesional, i cili përballë me rreziqe të larta për shkak të natyrës së punës së tyre. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kushteve shëndetësore dhe sigurisë në punë, duke siguruar që minatorët të kenë akses në shërbime shëndetësore dhe mbrojtje sociale.

**II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektligj është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale për minatorët në Shqipëri. Ai adreson një numër problemesh që kanë prekur këtë grup për një kohë të gjatë dhe krijon mundësi për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit. Me angazhimin e duhur për zbatimin dhe mbështetje të mjaftueshme financiare, ky ligj ka potencialin të sjellë përmirësime të ndjeshme për minatorët dhe komunitetet e tyre.

Përmes tij synohet

1. **Përmirësimi i Kushteve të Punës:** Me miratimin e ligjit, pritet të rriten standardet e sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, duke reduktuar numrin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.
2. **Rritja e Motivimit dhe Produktivitetit:** Mbrojtja e përmirësuar sociale dhe sigurimi i një pensioni të përshtatshëm do të rrisin motivimin e minatorëve, çka do të ndikojë pozitivisht në produktivitetin e tyre.

- 3. Stabiliteti Ekonomik dhe Social:** Sigurimi i të drejtave dhe përfitimeve për minatorët do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit social dhe ekonomik në komunitetet ku ata punojnë, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar.

Shifrat e publikuara nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, tregojnë se 20% e aksidenteve në punë në Shqipëri shpesh me pasoja fatale për jetën, ndodhin në miniera, çka tregon se sa i dobishëm do të ishte statusi i minatorit për këtë kategori. Numri i minatorëve që kanë humbur jetën në subjektet pa licencë mbetet i pa përcaktuar. Për këtë arsye është e nevojshme miratimi i një statute

4. III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputetje të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin e acqis communitee.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji për statusin e minatorit përbëhet nga 16 nene, të cilat përcaktojnë kornizën ligjore për mbrojtjen dhe përfitimet e minatorëve në Shqipëri.









- 1. Neni 1 - Qëllimi i Ligjit:** Definin qëllimin e ligjit për rregullimin e statusit të minatorëve dhe sigurimin e mbrojtjes sociale.
- 2. Neni 2 - Përkufizime:** Përcakton termat kryesorë të përdorur në ligj, si "minator", "pension suplementar" dhe "aksident në punë".
- 3. Neni 3 - Kushte Pune dhe Shëndeti:** Siguron që minatorët të kenë kushte të sigurta pune dhe shërbime shëndetësore.
- 4. Neni 4 - E Drejta për Pension të Veçantë:** Rregullon të drejtat për pension për minatorët në përputhje me vitet e shërbimit dhe rrezikshmërinë e profesionit.
- 5. Neni 5 - Trajnime dhe Zhvillim Profesional:** Përcakton të drejtën e minatorëve për trajnim dhe zhvillim profesional.
- 6. Neni 6 - Paga:** Rregullon nivelin minimal të pagës për minatorët.
- 7. Neni 7 - Kompensime për Aksidente në Punë:** Definin të drejtat për kompensim në rast aksidentesh në punë.
- 8. Neni 8 - Sigurimi i Papunësisë:** Përcakton të drejtat e minatorëve në rast humbjeje të vendit të punës.
- 9. Neni 9 - Trajtimi i Familjarëve në Rast të Humbjes së Jetës në Punë:** Rregullon përfitimet për familjarët e minatorëve që humbasin jetën gjatë punës.

10. **Neni 10 - Përfitimi i Pensionit:** Përcakton procedurat për llogaritjen dhe përfitimën e pensioneve.
11. **Neni 11 - Afati për Përfitim:** Rregullon të drejtat për përfitimën e pensioneve dhe afatet e aplikimit.
12. **Neni 12 - Financimi:** Përcakton burimet e financimit për përfitimet e parashikuara nga ky ligj.
13. **Neni 13 - Trajtimi Mjekësor dhe Social:** Siguron qasje në kujdes shëndetësor falas dhe trajtim për minatorët.
14. **Neni 14 - Dokumentacioni për Marrjen e Statusit:** Rregullon procedurat për aplikimin për statusin e minatorit.
15. **Neni 15 - Aktet Nënligjore:** Ngarkon Këshillin e Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e ligjit.
16. **Neni 16 - Hyrja në Fuqi:** Përcakton datën e hyrjes në fuqi të ligjit pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Referuar kushteve për pension, bazuar në të dhënat që disponohen, nmri i përfituesve minatorë parashikohet të jetë rreth 13 300 persona dhe efekti përlllogaritjet rreth 1 275 840 000 lekë në vit ndërkohë që për minatorët nëntokë në buxhetin e ,

DEPUTETE

1. Jovide Tebelu 
2. Gazment Bandi 
3. Ajron Gekmarkaj 
4. Ina Zhupa 
5. EDI PALOKA 
6. Xhelal Azizi 
7. Dukut Sufi 
8. KRISTINK SOLCARI 
9. Leftar Qeshkenja 